



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



Nr. 01 / 2021

Dt. 15.01.2021

Date :15.01.2021

Në pajtim me nenin 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.8 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP nxjerrë këtë:

## NJOFTIM

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) kërkon nga të gjithë **Zyrtarët përgjegjës të prokurimit të Autoriteteve Kontraktuse të Kosovës** që të dërgojnë **raportet vjetore për kontratat e nënshkruara publike** për vlera të mëdha, të mesme, të vogla dhe minimale për vitin fiskal 2020, më së largu deri me **01.02.2021** në KRPP.

Meqenëse sistemi gjeneron raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike, të cilat janë zhvilluar përmes platformës elektronike E-prokurimit, nga Autoriteti Kontraktues (AK) kërkohet që raporti të dërgohet në formatin që gjenerohet nga sistemi dhe plotësohet me:

1. Aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale
2. Procedurat tjera të prokurimit të cilat nuk janë zhvilluar përmes platformës elektronike dhe
3. Numri i aktiviteve të anuluar të ndara sipas vlerës së kontratës.

Me rastin e gjenerimit të raportit vjetor nga sistemi i prokurimit elektronik, AK-se duhet t'a kenë parasyshë që raporti **nuk përfshinë** kontratat për të cilat **nuk është publikuar Njoftimi për nënshkrim të kontratës (B52)**, prandaj është përgjegjësi e AK që këto kontrata t'i përfshijë manualisht në raportin final i cili dërgohet në KRPP dhe t'i identifikoj si kontrata për të cilat nuk është publikuar B52.

Formulari B53 - Raporti vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike, dorëzohen në **formën exel në KRPP**. Gjithashtu, në raport të përfshihen edhe numri i procedurave të negociuara të cilat janë përdorur për aneks kontratë.

Adresa elektronike për dërgimin e raporteve është:

[shpalljekrpp@rks-gov.net](mailto:shpalljekrpp@rks-gov.net)

tel: 038-213-710

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

